REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDE

PROJEKT-VENDIM

Nr.72, datë 30.05.2025

"PËR MIRATIMIN MARRËVESHJES SË BASHKËINVESTIMIT NDËRMJET FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT DHE BASHKISË SARANDË ME OBJEKT: "PROJEKTIMI, NDËRTIMI, ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I PROJEKTIT "POLI I ZHVILLIMIT TURISTIK NË SARANDË"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 8 pika 1, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", pika 1.6 shkronja "a", neni 54 , neni 64 shkronja "a","b" dhe "gj", Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 9.1.2008 "Për miratimin e listës paraprake, të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Sarandë të qarkut të Vlorës", Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 235, datë 23.3.2011 "Për kalimin në pronësi, të bashkisë Sarandë, të sipërfaqes 9200 m², nga trualli funksional i pronës nr. 206 "Rezidenca qeveritare Sarandë", për një ndryshim në vendimin nr.1058, datë 16.7.2008 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare", të ndryshuar, dhe për një ndryshim në vendimin nr.20, datë 9.1.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Sarandë të qarkut të Vlorës" , Këshilli Bashkiak pasi morri në shqyrtim relacionin e përgatitur nga Drejtorisë së Projekteve, Turizmit dhe Integrimit Europian, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

VENDOSI:

1. Miratimit e marrëveshjes së bashkëinvestimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Sarandë për objektin " *Projektimi, ndërtimi , administrimi dhe menaxhimi i qëndrueshem i projektit "Poli i Zhvillimit Turistik në Sarandë*",sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Z.Oltion ÇAÇI, për nënshkrimin e së miratuar në pikën 1 dhe të çdo akti tjetër të nëvojshëm që rrjedh prej kësaj marrëveshjeje.
3. Shfuqizohet çdo vendim i Këshillit Bashkiak i cili bien ndesh me parashikimet e këtij vendimi.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë Sarandë dhe Drejtorisë së Projekteve, Turizmit dhe Integrimit Europian, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Irena MARJANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SARANDË

FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

BASHKIA SARANDË

MARRËVESHJE BASHKËINVESTIMI

ndërmjet

Fondit Shqiptar të Zhvillimit

dhe

Bashkisë Sarandë

Me objekt:

"Projektimi, ndërtimi, administrimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i projektit "Poli i Zhvillimit Turistik në Sarandë"

TIRANË ____.____.2025

Marrëveshje BASHKËINVESTIMI

Kjo Marrëveshje Bashkëinvestimi, lidhet sot më datë ____.____.2025 ndërmjet:

Fondit Shqiptar të Zhvillimit, person juridik shqiptar, i regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr.5061, datë 16.06.1993, organizatë jofitimprurëse që funksionon në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 10 130 datë 11.5.2009 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", i ndryshuar, pajisur me NIPT J62325010Ë dhe adresë: rruga "Sami Frashëri", nr. 10, Tiranë, Shqipëri, që këtu e në vijim do të quhet "FSHZH", përfaqësuar nga **z. Dritan Agolli,** Drejtor Ekzekutiv;

dhe

Bashkisë Sarandë, person juridik publik, që organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, me seli në adresën: rruga "Abedin Dino", nr. 11, Sarandë, përfaqësuar nga **z. Oltion Çaçi**, Kryetar i Bashkisë.

MEQENËSE:

i. Bashkia Sarandë referuar parashikimeve të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ka detyrimin për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave dhe pronave që ka në pronësi në funksion të zhvillimit të tyre si dhe është përgjegjëse për planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit;
ii. Bashkia Sarandë është pronare e një pjesë të truallit dhe ndërtesave për të cilat ka kërkuar mbështetjen për financimin e projektit **"Poli i zhvillimit turistik në Sarandë"**, sipas certifikatave të pronësisë;
iii. Bashkia Sarandë ka shprehur interes edhe për partneritet me FSHZH-për realizimin e projektit si dhe administrimin dhe menaxhimin e aktivitetit ekonomik që parashikohet të zhvillohet në të;
iv. FSHZH referuar parashikimeve të Ligjit nr. 102/2020 "Për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin" është promotor i incentivave që gjenerojnë zhvillim ekonomik e social në funksion të së cilës ka krijuar persona juridikë, me qëllim mbështetjen e njësive vendore në menaxhimin dhe rigjenerimin e aseteve publike dhe të aktiviteteve ekonomike, të cilët kanë eksperiencë në menaxhimin e aseteve publike dhe aktivitetit ekonomik;
v. Në kuadër të programit buxhetor "Infrastruktura Vendore Rajonale", në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 97/2023, datë 07.12.2023, "Për Buxhetin e Vitit 2024", miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 23917/153 prot., datë 12.02.2024, është miratuar ndërhyrja "Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele më të lartë të zhvillimit Loti 3, Poli i zhvillimit turistik në Sarandë";
vi. Me Vendimin e Këshillit Drejtues të FSHZH-së nr. 259 datë 27.03.2024 është miratuar programi operacional i Fondit Shqiptar të Zhvillimit për vitet 2024–2030, detajimi i financimit afatmesëm 2024-

2026 si dhe mekanizmat në zbatim të tij", i ndryshuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të FSHZH-së nr. 265 datë 10.09.2024, miratuar për financim me shkresën e Ministrisë së Financave, nr. 11852/8 prot., datë 13.09.2024;

vii. FSHZH-së me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 264, datë 09.05.2025, i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi pasuritë me nr.15/451, nr.15/209, nr.15/445, nr.15/447 dhe nr.18/451, në zonën kadastrale 8642, Sarandë, me qëllim realizimin e projektit "Poli i zhvillimit turistik në Sarandë";

viii. FSHZH dhe Bashkia Sarandë kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit datë 23.11.2023 me objekt: *"Rregullimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimeve mes palëve në funksion të zhvillimit të zonës "Eko–Kampusi Arsimor Sarandë dhe ish-Rezidenca e Shërbimeve Qeveritare Sarandë*", në pronësi të Bashkisë Sarandë, me vendndodhje në zonën "Turizëm–Kanali i Çukës", Sarandë;

ix. FSHZH ka hartuar projektin e zhvillimit të zonës, ku me Vendim të KKTU-së, nr. 50, datë 24.12.2024 është miratuar Leja e Ndërtimit për objektin "Poli i zhvillimit turistik në Sarandë, Loti 3", Bashkia Sarandë;

x. FSHZH dhe Bashkia Sarandë kanë shprehur dakordësinë për të hyrë në partneritet për investimin me objekt "Për projektimin, ndërtimin, administrimin, menaxhimin e Polit të zhvillimit turistik të Sarandës", ku për rikonstruksionin e shkollës dhe ndërtimin e palestrës, pjesë e këtij projekti (sipas aneksit 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj marrëveshje), palët lidhin Marrëveshje Investimi dhe përfitues do të jetë bashkia Sarandë;

xi. FSHZH dhe Bashkia Sarandë nënshkruajnë këtë marrëveshje bashkëinvestimi për rikonstruksionin e vilës qeveritare, ndërtimin e godinave të strukturës akomoduese, restorantit, qendrës multifunksionale kulturore, pishinës së jashtme me funksionet mbështetëse si dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe sistemimin e hapësirave të jashtme në funksion të zonës;

PËR SA MË SIPËR,

Palët bien dakord të bashkëpunojnë nëpërmjet angazhimeve reciproke për të arritur qëllimet e tyre të përbashkëta si më poshtë vijon:

NENI 1
PËRKUFIZIME

1.1 **Marrëveshje bashkë-investimi,** marrëveshje ku palët me vullnetin e tyre të lirë, angazhohen të marrin përsipër të drejta dhe detyrime për të siguruar realizimin e projektit "Poli i zhvillimit turistik në Sarandë".

1.2 **Objekti,** nënkupton për rikonstruksionin e vilës qeveritare, ndërtimin e godinave të strukturave akomoduese, restorantit, qendrës multifunksionale kulturore, pishinës së jashtme me funksionet mbështetëse si dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe sistemimin e hapësirave të jashtme në funksion të zonës.

1.3 **Administrimi i pronës,** në kuptim të kësaj marrëveshje është ruajtja dhe mirëmbajtja me qëllim rritjen e vlerës ekonomike të saj.

1.4 **Menaxhimi i aktivitetit ekonomik,** në kuptim të kësaj marrëveshje është e drejta për të menaxhuar aktivitetin ekonomik që do zhvillohet në pronë.

NENI 2
OBJEKTI I MARRËVESHJES

Palët bien dakord se objekti i kësaj Marrëveshje është projektimi, ndërtimi, administrimi dhe menaxhimi i projektit "Poli i zhvillimit turistik në Sarandë", në mënyrë specifike për rikonstruksionin e vilës qeveritare, ndërtimin e godinave të strukturës akomoduese, restorantit, qendrës multifunksionale kulturore, pishinës së jashtme me funksionet mbështetëse si dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe sistemimin e hapësirave të jashtme në funksion të zonës, sipas Aneksit 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj marrëveshje.

Për realizimin e këtij projekti, bashkia Sarandë do të sigurojë një pjesë të truallit konkretisht pasuritë me nr. 15/452, 15/420, 15/443, 15/157, 15/442, 15/449, të cilat i ka në pronësi dhe e pajisur me certifikata pronësie, ndërsa FSHZH do të vendosë në dispozicion pasuritë nr.15/451, nr.15/209, nr.15/445, nr.15/447 dhe nr.18/451, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 264, datë 09.05.2025 si dhe do të mundësojë financimin e investimit për realizimin e projektit, sipas Aneksit 2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj marrëveshje.

NENI 3
BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje bazohet në:

3.1 Ligjin nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen Vendore", neni 8/1, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", pika 1.6 shkronja "a", neni 64 shkronja "a", "b" dhe "gj";

3.2 Ligji nr 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

3.3 Ligji nr. 10 130, datë 11.5.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", i ndryshuar, neni 6 pika 2, neni 7 shkronja "dh";

3.4 Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 265 datë 10.09.2024, i ndryshuar;

3.5 Vendimi i Këshillit Drejtues të FSHZH nr.____, datë ___.___.2025, "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëinvestimit ndërmjet FSHZH dhe Bashkisë Sarandë për "Polin e Zhvillimit turistik në Sarandë";

3.6 Vendimi i Këshillit Bashkiak, Sarandë nr.____, datë ___.___.2025, "Për miratimin e Masterplanit të projektit "Poli i Zhvillimit turistik në Sarandë" dhe miratimin e marrëveshjes së bashkëinvestimit ndërmjet FSHZH dhe Bashkisë Sarandë për realizimin e këtij projekti";

3.7 Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 9.1.2008, "Për miratimin e listës paraprake, të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Sarandë të qarkut të Vlorës";

3.8 Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 235, datë 23.3.2011, "Për kalimin në pronësi, të bashkisë Sarandë, të sipërfaqes 9200 m², nga trualli funksional i pronës nr. 206 "Rezidenca qeveritare Sarandë", për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për

Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare", të ndryshuar, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 20, datë 9.1.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Sarandë të qarkut të Vlorës";

3.9 Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 297, datë 20.4.2016, "Për kalimin në pronësi, nga drejtoria e shërbimeve qeveritare te bashkia Sarandë, të pronës me emërtimin "Rezidencë qeveritare", me vendndodhje në zonën kadastrale 8642, Sarandë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për drejtorinë e shërbimeve qeveritare";

3.10 Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 264, datë 09.05.2025, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi te Fondi Shqiptar i Zhvillimit të pasurive nr.15/451, nr.15/209, nr.15/445, nr.15/447 dhe nr.18/451, në zonën kadastrale 8642, Sarandë".

NENI 4
PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

4.1 Ky projekt synon transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit, duke kontribuar në rigjenerimin ekonomik dhe social të zonës përmes këtyre objektivave kryesore:

- Rigjenerimi i aseteve të pashfrytëzuara, për t'i kthyer ato në qendra të integruara që krijojnë vlerë të shtuar për komunitetin dhe ekonominë lokale;

- Zhvillimi i zinxhirit ekonomik me vlerë të shtuar, përmes integrimit të sektorëve si turizmi, rekreacioni dhe sistemi ushqimor lokal, duke nxitur ndërveprimin e tyre në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm;

- Zhvillimi i kapaciteteve të dijes për të rinjtë, në një ekosistem real pune, ku brezi i ri përfiton njohuri praktike nga përfshirja në aktivitete konkrete dhe projekte reale;

- Ngritja dhe zhvillimi i partneriteteve publik-publik, për të krijuar sinergji ku do të ndërveprojnë të gjithë aktorët e interesuar, përfshirë universitetin, shkollat profesionale dhe institucionet kërkimore;

- Nxitja e një klime të favorshme për sipërmarrjet e reja, përmes krijimit të kushteve mbështetëse dhe tërheqjes së investimeve vendase dhe të huaja.

4.2 Projekti "Poli i zhvillimit turistik në Sarandë" është i pozicionuar në Kodrën e Gjashtës, me sip. rreth 3.2 hektarë. Zona kufizohet në Veri nga Varrezat e Dëshmorëve, Lindje nga rruga "Sarandë – Kanali i Cukës", në Perëndim nga rruga "Butrinti" dhe konsiston në rikonstruksionin e vilës qeveritare, ndërtimin e godinave të strukturës akomoduese, restorantit, qendrës multifunksionale kulturore, pishinës së jashtme me funksionet mbështetëse si dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe sistemimin e hapësirave të jashtme në funksion të zonës.

NENI 5

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

5.1 Aktiviteti që do të kryhet në "Polin e zhvillimit turistik në Sarandë", do të jetë ofrimi i shërbimeve të dijes së aplikuar në sektorin e mikpritjes dhe turizmit, ofrimi i hapësirave për shkollim, mjediseve të rekreacionit dhe eventesh didaktike e kulturore si dhe ofrimi i hapësirave muzeale. Gjithashtu do të ofrohen hapësira për aktivitete akomodimi dhe shërbimesh, të shoqëruara me mjedise në shërbim të zhvillimit të sipërmarrjeve të reja dhe aktiviteteve, të cilat gjenerojnë vetë qëndrueshmëri financiare si rikonstruksioni i vilës qeveritare, ndërtimi i godinave të strukturës akomoduese, restorantit, qendrës multifunksionale kulturore, pishinës së jashtme me funksionet mbështetëse si dhe ndërtimi i infrastrukturës rrugore dhe sistemimi i hapësirave të jashtme në funksion të zonës.

5.2 Një pjesë e Aktiviteteve do të ofrohen me pagesë dhe/ ose në formë të stimuluar në bazë të marrëveshjeve individuale.

5.3 Aktiviteti ekonomik do të jetë në përputhje me objektivat të përcaktuara në koncept idenë zhvillimore.

5.4 Të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti ekonomik do të shpërndahen sipas specifikimeve të përcaktuara në këtë marrëveshje.

5.5 Ofrimi i këtij shërbimi do të mundësojë zhvillimin e qëndrueshëm të zonës dhe më gjerë në funksion të ofrimit të shërbimeve për vizitorët, turistët dhe banorët.

NENI 6
BASHKËPRONËSIA

Pas përfundimit të realizimit të investimit "Poli i zhvillimit turistik në Sarandë", i cili përfshin rikonstruksionin e vilës qeveritare, ndërtimin e godinave të strukturës akomoduese, restorantit, qendrës multifunksionale kulturore, pishinës së jashtme me funksionet mbështetëse si dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe sistemimin e hapësirave të jashtme në funksion të zonës, do të rregjistrohen pranë Agjencisë Shtetërore e Kadastrës në bashkëpronësi të bashkisë Sarandë dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit në pjesë të barabarta.

NENI 7
TË DREJTAT DHE DETYRIMET PALËVE

Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:

7.1 Të vendosë në dispozicion pasuritë nr.15/451, nr.15/209, nr.15/445, nr.15/447 dhe nr.18/451, në zonën kadastrale 8642 si dhe të sigurojë financimin për projektimin dhe zbatimin e punimeve dhe realizimin e objektit.

7.2 Të kryejë prokurimin e projektit të zbatimit të punimeve dhe realizimin e punimeve, shërbimeve të mbikqyrjes dhe kolaudimit në përputhje me legjislacionin shqiptar.

7.3 Të realizojë projektin e zbatimit dhe punimet për zbatimin e projektit.

7.4 Në përfundim të realizimit të investimit të ndjekë procedurat ligjore për regjistrimin pranë ASHK të objektit sipas pjesëve të bashkëpronësisë të parashikuara në nenin 6.

7.5 Palët bien dakord që FSHZH të ushtrojë të drejtën për administrimin dhe menaxhimin e aktivitetit ekonomik për 5 vitet e para të funksionimit të "Polit të zhvillimit turistik në Sarandë" dhe pas kalimit

të këtij afati palët do të vendosin me marrëveshje ndërmjet tyre për menaxhimin dhe administrimin e tij, përveç kur palët vendosin ndryshe bashkërisht.

Bashkia Sarandë ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:

7.6 Të vendosë në dispozicion të realizimit të projektit pasuritë 15/452, 15/420, 15/443, 15/157, 15/442, 15/449 me qëllim realizimin e projektit "Poli i zhvillimit turistik në Sarandë", në zonën e Kodrës së Gjashtës dhe të garantojë se nuk ka pengesa ligjore, konflikt juridik dhe/ose social që lind nga pronësia mbi sheshin e ndërtimit ku do të zbatohet projekti.

7.7 Të realizojë procedurat ligjore për shpronësim për interes publik të pasurive me nr 15/159, 15/221 dhe 15/216 si dhe të çdo pasurie tjetër të nevojshme për realizimin e projektit, përpara fillimit të punimeve të ndërtimit, si dhe të marrë përsipër përgjegjësinë për zgjidhjen e problemeve juridike dhe/ose sociale që lindin nga pronësia mbi truallin dhe çdo lloj problemi tjetër të mundshëm që pengon zbatimin e punimeve.

7.8 Të marrë përsipër që në çdo konflikt të mundshëm gjyqësor që rrjedh nga zbatimi i objektit të kësaj marrëveshje, NjVV-ja të futet në pozitën procedurale të të paditurit në vend të FSHZH-së, sipas nenit 184 të K.Pr.C.-së si dhe merr përsipër çdo detyrim nga konflikte gjyqësore të lindura nga marrëdhëniet e krijuara ndërmjet Bashkisë dhe palëve të treta, në lidhje me objektin e kësaj marrëveshje, duke pranuar se FSHZH apo subjekti përfaqësues i FSHZH nuk do të jetë palë dhe çdo detyrim i ngarkohet Bashkisë.

7.9 Të miratojë projektin teknik, objekt i kësaj marrëveshje në mbështeje të ligjit nr. 139/2015, i ndryshuar.

7.10 Të marrë përsipër përjashtimin e NJVV-së dhe FSHZH-së nga detyrimi për të paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë, në aplikim të nenit 46/3 të ligjit 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

7.11 Të sigurojë lirimin dhe dorëzimin e sheshit të ndërtimit të projektit, shoqërisë zbatuese të punimeve brenda 5 ditëve nga miratimi i lejës së ndërtimit të objektit.

7.12 Të mos transferojë detyrimet në një entitet tjetër juridik (person fizik apo juridik) në lidhje me mbarëvajtjen për administrimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e këtij investimi.

7.13 Asnjë detyrim i mëparshëm i Bashkisë lidhur me objektin e projektit, nuk do të mbartet mbi asetin apo aktivitetin ekonomik të lidhur me të gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshje.

NENI 8
SHPËRNDARJA E FITIMIT

8.1 Aktiviteti ekonomik që do të zhvillohet në Polin e Zhvillimit turistik në Sarandë, do të menaxhohet nga strukturat menaxhuese në varësi të bashkë-investuesve.

8.2 Struktura menaxhuese ka detyrimin të përgatisë planin e biznesit 6 muaj përpara fillimit të menaxhimit të aktivitetit, i cili miratohet nga palët bashkë-investuese.

8.3 Fitimi neto nga ky aktivitet ekonomik do të ndahet midis palëve bashkëinvestuese sipas vendimmarrjes dhe dakordësisë së tyre në raport 50 përqind me 50 përqind.

8.4 Në rastet kur aktiviteti ekonomik do të rezultojë pa fitim, kostot e aktivitetit do të mbulohen nga struktura përgjegjëse për menaxhimin.

8.5 Struktura menaxhuese do të administrojë fitimin, duke bërë më pas shpërndarjen e tyre tek pala tjetër një herë në vit pas miratimit të pasqyrave financiare vjetore.

NENI 9
MENAXHIMI I AKTIVITETIT EKONOMIK

9.1 Sikurse parashikohet në nenin 8, palët bien dakord që FSHZH nëpërmjet personave juridikë ku është ortak i vetëm, të ushtrojë të drejtën për menaxhimin e aktivitetit ekonomik për 5 vitet e para përveç kur palët vendosin ndryshe bashkarisht dhe pas këtij afati menaxhimi i aktivitetit ekonomik do të vendoset me marrëveshje mes palëve.

9.2 Me përfundimin e afatit të menaxhimit nga një strukturë përgjegjëse, palët në marrëveshje midis tyre përcaktojnë menaxhimin e objektit nga struktura që e ka në menaxhim ose kalimin tek struktura përgjegjëse e palës tjetër ose menaxhimi i objektit i jepet një pale të tretë publike apo private.

9.3 Struktura përgjegjëse për menaxhimin do të kryejë menaxhimin duke garantuar që cilësia dhe standardet e shërbimit të jenë në përputhje me funksionet e tyre.

9.4 Struktura përgjegjëse për menaxhimin e Polit të Zhvillimit turistik në Sarandë është përgjegjëse për funksionimin e shërbimeve në objekt me cilësi dhe në dobi të qytetarëve.

9.5 Struktura përgjegjëse për menaxhimin ka përgjegjësinë për ngritjen e një sistemi transparent të monitorimit dhe kontrollit që garanton aksesin e përhershëm nga ana e palëve të kësaj marrëveshje.

9.6 Struktura përgjegjëse për menaxhimin do të përgatisë një informacion periodik tre mujor për aktivitetin ekonomik të zhvilluar në objekt dhe do t'ia vërë në dispozicion të dyja palëve.

NENI 10
NDRYSHIME

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjellë me shkrim të të dy Palëve.

NENI 11
KOHËZGJATJA

11.1 Kjo Marrëveshje lidhet për një afat të pacaktuar.

11.2 Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet në çdo kohë me marrëveshje të përbashkët të Palëve.

11.3 Në rast të zgjidhjes së Marrëveshjes në mënyrë të njëanshme nga palët, pala që zgjidh marrëveshjen detyrohet t'i shpërblejë palës tjetër dëmet e shkaktuara nga kjo zgjidhje.

NENI 12
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

12.1 Bashkia dhe FSHZH do të bëjnë çdo përpjekje për të zgjidhur miqësisht me negociata çdo mosmarrëveshje ose konflikt që mund të kenë midis tyre për çfarë lidhet me këtë Marrëveshje.

12.2 Nëse pas tridhjetë ditësh nga fillimi i negociatave informale konflikti nuk zgjidhet, mund të angazhohet një palë e tretë e pavarur për ndërmjetësim. Në rast se edhe pas kësaj konflikti nuk zgjidhet, palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

12.3 Palët e kësaj Marrëveshje njohin dhe pranojnë që çdo gjykim do të bëhet duke u bazuar në kushtet dhe kërkesat e kësaj Marrëveshje.

NENI 13
KOMUNIKIMI

13.1 Komunikimi midis palëve do të jetë i vlefshëm vetëm kur bëhet me shkrim.

13.2 Një njoftim do të jetë i vlefshëm vetëm pasi të ketë mbërritur në destinacionin e tij.

NENI 14
HYRJA NË FUQI

14.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas miratimit paraprak të saj nga organet vendimmarrëse përkatëse të secilës palë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve.

14.2 Kjo Marrëveshje është hartuar në 4 kopje të barasvlershme mes tyre.

Lexuar dhe Aprovuar:

Drejtori Ekzekutiv i FSHZH

Dritan AGOLLI

Emër, Mbiemër, Firmë, Vulë

Kryetari i Bashkisë Sarandë

Oltion ÇAÇI

Emër, Mbiemër, Firmë, Vulë

ANEKSI 1 - Master plani i zonës

